

Reagim nga Posta e Kosovës

E nderuara redaksi,

Bordi i Postës së Kosovës, në një reagim të dërguar në KALLXO.com, kanë thënë se ata nuk janë përgjegjës për performancën e kompanisë në vitin 2018 kur është bërë raporti i Auditorit, meqë ata janë zgjedhur në vitin 2019.

Por, në reagimin e tyre, Posta e Kosovës nuk kanë treguar se tre nga anëtarët e bordit që janë emëruar në vitin 2019 kanë qenë edhe më herët pjesë e bordit.

Posta e Kosovës, në reagimin e tyre kanë folur edhe për uzurpimin e pronave të kësaj ndërmarrje. Ata kanë thënë se uzurpimi i pronave të Postës së Kosovës në veri të Kosovës është që nga viti 1999. Kurse, sa i përket gjashtë banesave në Prishtinë, Posta e Kosovës ka thënë se me këto prona është duke u marrë Ndërmarrja Publike Banësore dhe për to ka një vendim të Gjykatës Themelore, mirëpo që duhet të pritet edhe vendimi i Gjykatës së Apelit.

Reagim ndaj shkrimit të portalit kallxo.com me titull “Shkeljet që mund të çojnë në shkarkimin e Bordit të Postës së Kosovës”, i autores Dorentina Kastrati, i botuar më 23.2.2020, në ora 14:29.

Për hir të informimit të drejtë të publikut, jemi të detyruar të reagojmë dhe të përgënjeshtrojmë një varg të pavërtetash të botuara në portalin tuaj kallxo.com.

Së pari, titulli i shkrimit, i cili është plotësisht joprofesional dhe tendencioz, na ka indinjuar të gjithëve në ndërmarrjen publike Posta e Kosovës Sh.A.

Megjithëse gazetarja juaj dhe redaksia juaj kanë qenë të informuar që Bordi i Drejtorëve të Postës së Kosovës është zgjedhur me konkurs të rregullt në qershor të viti 2019, atëherë si është e mundur që t’i atribuohen shkelje, për të cilat pohohet se kanë ndodhur gjatë viteve 2015-2018, e për më tepër të paragjykohet madje edhe shkarkimi i Bordit nga Qeveria?!

Çfarë shkelje ka bërë Bordi i Drejtorëve i zgjedhur në qershor të vitit 2019?

Autorja dhe redaksia e kallxo.com nuk e ka parë fare të udhës t’i kontaktojë organet përkatëse të Postës së Kosovës dhe të merr përgjigje edhe për këto çështje, duke i lejuar vetes të dezinformojë opinionin publik.

E pavërteta tjetër në shkrimin tuaj ka të bëjë me uzurpimet e pronave të Postës së Kosovës.

Uzurpimi i pronave në veri të Kosovës nga operatori publik postar i Serbisë dhe në enklava të kontrolluara nga strukturat serbe brenda Kosovës është bërë në vitin 1999, në kohën kur nuk ka ekzistuar ndërmarrja e sotme Posta e Kosovës. Posta e Kosovës, e themeluar në vitin 2012, ka bërë çmos t’i lejohet qasja në objektet e uzurpuara nga strukturat paralele serbe, por kërkesat tona ende nuk janë realizuar.

Në tekstin tuaj është e përfshirë edhe e pavërteta tjetër se gjoja Posta e Kosovës ka toleruar që gjashtë apartamente banësore në Prishtinë të mbeten të uzurpuara dhe se kompania nuk ka kontroll dhe nuk realizon përftime ekonomike në këto prona, si rezultat vlera e pasurive është mbivlerësuar. Në raportin e Auditorit të ZKA askund nuk thuhet se Posta apo më herët PTK ka toleruar këtë uzurpim. Prandaj, pse ju dezinformoni?!

Posta e Kosovës i sqaron redaksisë, autores dhe opinionit publik, se këto 6 apartamente janë trashëguar në regjistra kontabël nga ndarja e PTK-së në vitin 2012, dhe se kontrollin, administrimin dhe procesin gjyqësor kundër uzurpatorëve të paligjshëm nga viti 1999 e deri më sot e bën Ndërmarrja Publike Banesore (NPB) në Prishtinë, nga e cila pas ndarjes nga ish-PTK, kemi kërkuar disa herë me shkresa, kërkesa e komunikime që të na dorëzohen, por përgjigjja e zyrtarëve të NPB-së ka qenë dhe mbetet se në shkallën e parë të gjykimit i ka fituar rastet për lirim të 6 banesave. Apartamente të uzurpuara në këtë objekt kolektiv në lagjen “Dardania” në Prishtinë kanë edhe ndërmarrjet tjera publike siç është KEK-u, etj. Sipas NPB-së, duhet pritur vendimin e Gjykatës së Apelit që ne t’i kthejmë pronat tona të lartpërmendura.

Bordi dhe Menaxhmenti nuk kanë mundur të bëjnë asgjë nga gjendja faktike dhe juridike e shpjeguar më lart në rastin e 6 banesave në Prishtinë, kurse sa i përket regjistrimit në pasqyrat financiare dhe kontabilitet, Bordi dhe Menaxhmenti janë pajtuar me raportin e ZKA-së që ato shpalosje të evidentohen në pasqyra konform gjendjes faktike dhe juridike të pasurisë.

E pavërteta tjetër qëndron në faktin se autorja dhe portali humbjet financiare të para 5 viteve ua ngarkon Bordit dhe Menaxhmentit ekzekutiv të ri, i cili është duke punuar me Plan të Biznesit për vitet 2020-2022 të aprovuar dhe se nuk ka asnjë mundësi të bëhet vlerësimi i performancës për 5 muajt e fundit të vitit 2019.

Posta e Kosovës kërkon nga autorja dhe redaksia e portalit kallxo.com që ta botojë pa ndërhyrje këtë DEMANT dhe i njofton se është duke shqyrtuar të gjitha mundësitë për padi për shpifje ndaj autores dhe portalit, me qëllim të mbrojtjes së imazhit, afarizmit, etj., të Postës së Kosovës dhe punëtorëve të saj.

Me respekt,

Bordi i Drejtorëve të Posta e Kosovës Sh.A.

Prishtinë

PËRGJIGJJA E KALLXO.COM NË REAGIMIN E POSTËS SË KOSOVËS

KALLXO.com sqaron se raportimi i bërë bazohet në faktet e listuara në raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, si dhe në hulumtimin e bërë për lidhjen e anëtarëve të bordit të Postës së Kosovës me partitë politike.

Ky raportim është bërë bazuar në paralajmërimin që kanë bërë Qeveria e Kosovës për analizimin e raporteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për secilën ndërmarrje Publike. Paralajmërimet e bëra nga qeveria në detyrë janë që do të ketë shkarkime në ndërmarrjet të cilat kanë pranuar raport negativë nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

KALLXO.com, krejt çka ka bërë, është publikimi i gjetjeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit sa i përket Postës së Kosovës.

Në reagimin e juaj, Ju keni thënë se bordi është zgjedhur në mes të vitit 2019, por nuk keni treguar se tre nga gjashtë anëtarët e bordit të Postës kanë qenë edhe në të kaluarën në bordin e Postës së Kosovës.

Pra, tre nga anëtarët e bordit të Postës së Kosovës kanë qenë edhe në bordin e kaluar, në mandatin 2015-2019, kurse raporti i Auditori është për vitin 2018.

Kurse, sa i përket uzurpimit të pronave dhe 6 lokale/banesave në Prishtinë, ju informojmë se ato janë pjesë e raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe kanë qenë bazë për Opinion të Kundër të dhënë nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Kryesuesi i bordit të Postës është pajtuar me këto gjetje dhe është zotuar t'i zbatojë rekomandimet.

Për më tepër, një pjesë e shkrimit të KALLXO.com ka të bëjë me konkursin e fundit që ka rezultuar me emërimin e bordit të ri të Postës së Kosovës. Raportimi i KALLXO.com tregon se si disa prej anëtarëve të bordit kanë të kaluar të lidhur me partitë politike, ndërkohë që Ligji për Ndërmarrjet Publike kërkon që anëtarët e bordit të jenë të pavarur në 36 muajt e fundit.